



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 10.4.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Evgjëni Thaçi-Drăgusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Elmi Reçica dhe Sergjan Mitroviç.

Me ftesë të komisionit, morën pjesë në takim: Besian Mustafa, drejtor i përgjithshëm i KIESA-s dhe Arbër Muhaxheri, drejtor i drejtorisë në KIESA.

Pjesëmarrësit e tjerë: Alban Bajrami dhe Egnesa Vitia – praktikantë dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim me z. Besian Mustafa, drejtor i përgjithshëm i Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në lidhje me sektorin e investimeve strategjike dhe për sfidat, të cilat paraqiten gjatë zbatimit të Ligjit për investime strategjike.

Vjosa Osmani-Sadriu, falënderoi z. Mustafa për gatishmërinë e tij për takim të përbashkët me komisionin dhe njoftoi se për herë të parë në këtë legjislaturë është përfshirë në fushëveprimin e komisionit edhe sektori i investimeve strategjike. Po ashtu, bëri të ditur se komisioni ende nuk është njoftuar nga MDIS, lidhur me këtë sektor, meqë edhe në këtë ministri, për herë të parë, përfshihet ky sektor. Lidhur me investimet strategjike, tha se shumica e aktiviteteve të parapara me ligj i takojnë KIESA-s, prandaj edhe janë ftuar në takim që të njoftojnë për zhvillimet në këtë sektor, aktivitetet dhe për sfidat në zbatimin e ligjit.

Besian Mustafa, njoftoi se KIESA është një agjenci e formuar më 2013, pas bashkimit të 2 agjencive, Agjencisë për Promovim në Kosovë dhe Agjencisë për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme në Kosovë. Agjencia, tani ka mandat për promovimin dhe mbështetjen e investimeve në tërësi, promovimin dhe mbështetjen e eksporteve, plasimin e produkteve jashtë Kosovës, promovimin dhe

mbështetjen e turizmit në Kosovë, projekte të ndryshme zhvillimore për ndërmarrje të vogla e të mesme në Kosovë, si dhe financimin dhe menaxhimin e zonave ekonomike në territorin e Kosovës. Më tej, theksoi se që nga themelimi i agjencisë kemi realizuar 44 panaire për promovimin e produkteve në Kosovë, 14 nga të cilat kanë qenë për promovimin e turizmit në Kosovë, ku kanë marrë pjesë 285 ndërmarrje të ndryshme kosovare apo operatorë turistikë. Po ashtu, bëri të ditur se kanë pasur 214 vizita të ndryshme të kompanive të huaja, të interesuara për të parë Kosovën nga afër. Në tri vitet e fundit, tha se kanë pasur 149 kompani që kanë përfituar programe të ndryshme zhvillimore dhe përkrahëse, që janë në pronësi ose udhëheqjen e grave. Për mbështetje dhe këshillime, njoftoi se kanë përfituar 179 kompani. Sipas programit për leadership biznesi për studentët në vitin e fundit apo të para-diplomuarve, gjatë 3 viteve kanë përfituar 440 studentë dhe 376 ndërmarrje publike. Po ashtu, njoftoi se gjatë kësaj periudhe ka udhëhequr 1122 vizita në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë dhe tek investitorët e huaj në Kosovë, me qëllim që të kenë informacione nga dora e parë mbi sfidat, zhvillimet e ambiciet e tyre. Gjithashtu, njoftoi se pas hyrjes në fuqi të Ligjit për investime strategjike, kanë nxjerrë edhe 4 akte nënligjore, të cilat mundësojnë zbatimin e këtij ligji. Si sfida thelbësore të KIESA-s, është nevoja për të hulumtuar tregun e huaj potencial dhe investitorët potencialë në Kosovë. Lidhur me zhvillimet në Kosovë, tha se ekziston një imazh jo i favorshëm për Kosovën, që nuk përkon me reformat e punës që po bëhen në terren. Kemi nevojë për një koordinim dhe një qartësim më të mirë me MDIS, tha z. Mustafa, duke vënë në pah se KIESA është bartëse kryesore e investimeve strategjike. Po ashtu, tha se KIESA nuk është vetëm agjenci e promovimit, por agjenci shtetërore e zhvillimit ekonomik dhe kërkohet një koordinim më i mirë i të gjitha organeve publike e private, për t'i bashkërenduar aktivitetet e tyre të promovimit me KIESA-n. Ndër sfidat kryesore, lidhur me zbatimin e Ligjit për investime strategjike, tha se janë mungesa e kapaciteteve njerëzore, administrative e financiare, për të promovuar dhe mbështetur investimet strategjike. Sipas tij, investimet strategjike kërkojnë një punë të madhe, koordinim me diplomacinë ekonomike, kulturore, shtetërore e sportive, për t'i bindur investitorët që të vizitojnë Kosovën e pastaj të negociohet për investim.

Vjosa Osmani-Sadriu, duke u ndërlidhur me diskutimin e z. Mustafës, pyeti atë: A mendon që Ligji për investime strategjike i ka eliminuar çështjet e barrierave burokratike, duke pasur parasysh se ekziston afati i kufizuar i implementimit dhe a kanë rekomandime specifike për eliminimin e tyre? Duke pas parasysh se KIESA është në kontakt me ambasadat e Kosovës, pyeti z. Mustafën: Ku kanë vërejtur se ka ngecur zhvillimi i diplomacisë ekonomike? Po ashtu, znj. Osmani-Sadriu kërkoi të informohet lidhur me sfidat që ishin paraqitur në projektin për Brezovicën.

Doruntinë Maloku-Kastrati, kërkoi të informohet nga z. Mustafa lidhur me investitorët nga Kanadaja, të cilët kanë shprehur interesimin për investim në miniera në Kosovë, porse ligji në fuqi nuk ua mundëson që të marrin fillimisht licencën për të konfirmuar rezervat e pastaj për të hartuar projektet e tyre për investime serioze në Kosovë. Pyeti z. Mustafën: A është shtuar nevoja që të plotësohet dhe ndryshohet ligji në fuqi, në mënyrë që të mundësohen procedurat për sjelljen e investitorëve në Kosovë?

Zafir Berisha, lidhur me imazhin e Kosovës, si një faktor i rëndësishëm për investime në Kosovë, theksoi se imazhin që e kenë, është shumë problem që për një periudhë të shkurtër të përmirësohet. Për shkak të pengesave ligjore, AKP-së, mosdefinimit të pronave, pushtetet lokale kanë probleme për të realizuar projekte me vite të tëra dhe të njëjtën kohë investitorët potencialë të interesuar, janë të zhgënjyer nga Kosova. Pyeti z. Mustafën: Çka është ndërmarrë lidhur me procedurat për bartjen e pronave në kompetencë të pushteteve ose lokale, ose vendore, me qëllim që investitorët të mos hasin

në këto pengesa që i kanë. Parku i Biznesit në Prizren, përkundër faktit që asambleja i ka bërë kërkesë Qeverisë për definimin e pronës, ende nuk ka mundur të funksionalizohet kjo hapësirë për investitorë.

Besian Mustafa, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara nga deputetët, tha se Ligji për investime strategjike e parashih shkurtimin e afateve të kthimit të përgjigjeve brenda 15 ditëve, për leje e licenca të ndryshme për investime strategjike. Ndryshimet strategjike do të ishin të mira, nëse i bëhet një rishikim disa ligjeve, ku KIESA do të ofronte mbështetjen, se cilat ligje e cilat nene do të mund të ndryshoheshin për t'i dhënë një kahe më përkrahëse projekteve që klasifikohen si investime strategjike. Sa i përket diplomacisë ekonomike, tha se nuk i kemi dhënë rëndësinë e duhur dhe në shumë ambasada nuk kemi atashe ekonomikë. Propozoi që ambasadat tona të plotësohen edhe me zyrtarë të veçantë për çështje ekonomike. Në kuadër të ERA-s, Qeveria është zotuar që të përforcojë KIESA-n, ku parashihet të kemi edhe atashe komercialë, që kanë për detyrë investimet dhe eksportin. Sa i përket çështjes së Brezovicës, tha se nuk është i klasifikuar si projekt strategjik, sipas ligjit në fuqi dhe deri më tani nuk kanë pasur sukses që të tërheqin investitorë në këtë drejtim. Më tej, tha se për t'u përmirësuar imazhi i Kosovës, kërkohet një punë mjaft e madhe dhe për këtë janë duke punuar në terren. Duke u ndërlidhur me zonën ekonomike në Prizren, tha se në përgjithësi, kuvendet komunale kanë pak prona të paluajtshme në pronësi të tyre. Ai njoftoi se për këtë, pjesërisht kanë bërë zgjidhje ligjore, përmes KIESA-s, por tani ajo pronë komunale kalon në pronësi të Qeverisë, ndërsa përfitimi ekonomik mbetet i komunës.

Visar Ymeri, tha se strategjia ekonomike e Kosovës, vazhdimisht ka munguar dhe në mungesë të një vizioni afatgjatë dhe të një planifikimi strategjik për zhvillimin ekonomik, ne mbetemi pjesë e një stihie kaotike të qarkullimit të kapitalit që ndodh në Kosovë. Lidhur me investimet e huaja, z. Ymeri tha se sipas vjetarit statistikor të Republikës së Kosovës, prej vitit 2007 deri në vitin 2016, shihet se ka një fluks të çuditshëm të shifrave që janë regjistruar si investime të huaja direkte. Sipas tij, industria duhet të jetë me një përqendrim të veçantë për politikat ekonomike, ku kemi një rënie nga viti 2010 tek investimet e huaja direkte në këtë sektor, duke shtuar se në vitin 2010 ka pasur investime në vlerë prej 101 milionë, kurse në vitin 2016 janë 5.3 milionë. Të rëndësishme, z. Ymeri e cilësoi nevojën që Kosova ta ketë një strategji afatgjate ekonomike, e cila do të duhet të përpilohet nga institucionet e Republikës së Kosovës, me një konsensus politik dhe shoqëror për atë se nga duhet të shkojmë ekonomikisht. Pyeti: Çfarë strategjie ndjek KIESA, cilat investime synon t'i promovojë dhe me çfarë mekanizmash shqyrtohen përmbushjet e kriterëve nga Ligji për investimet strategjike? Duke iu referuar raportit të KIESA-s, pyeti: A e përmbushin kriterin e punësimit katër aplikuesit e cekur në raport. Po ashtu, z. Ymeri pyeti: A ka bashkërendim, dhe nëse ka, deri në çfarë mase është i kënaqshëm bashkërendimi me institucionet tjera që bien në fushëveprimin e ekonomisë dhe a ka nevojë agjencia për më shumë kompetenca? Investimet e huaja direkte shkojnë më së shumti në vende që kanë një zhvillim të hovshëm ekonomik, siç janë Kina dhe vendet e BE-së dhe jo domosdo në vendet e listuar nga Banka Botërore. Përveç, pengesave burokratike, z. Ymeri tha se më problematike është pamundësia e realizimit të një investimi dhe leverdia ekonomike, e cila mund të paraqitet, pasi që Kosova ka shumë mangësi prej madhësisë së tregut, furnizimi me energji elektrike e deri te fuqia punëtore, e cila mund të jetë me bollëk, por deri diku është e papërdorshme, për shkak të mungesave të kualifikimit.

Time Kadrijaj, tha se Ligji për investimet strategjike është ligj i ri dhe ka qenë i nevojshëm për t'iu ikur procedurave burokratike. Pyeti: A ka KIESA koordinim me rrjetet e bizneseve shqiptare në diasporë, pasi që është një mundësi e mirë që përmes këtyre rrjeteve të sillen investitorë të huaj? Rrjetet e bizneseve shqiptare në diasporë, tha se mund ta kryejnë punën e atasheut diplomatik, të cilët mungojnë në ambasada. Po ashtu, pyeti: A ka KIESA përkrahjen financiare të Qeverisë, për t'i

zhvilluar aktivitetet e saja, si është trendi i investimeve, dhe për shkak imazhit të Kosovës, a mund të pritet që të kemi ngritje të investimeve këtë vit?

Doruntinë Maloku- Kastrati, lidhur me përmirësimin e imazhit të Kosovës, pyeti: Sa duhet të jetë buxheti i KIESA-s për këtë dhe si mund të ndihmojë Kuvendi në këtë drejtim?

Besian Mustafa, sa i përket zonës ekonomike të Podujevës, njoftoi se është e njëjta sfidë si me zonat tjera, pasi që prona e identifikuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës është nën menaxhim të AKP-së. Është duke u diskutuar mundësia që prona të shpronësohet nga MTI/KIESA, e cila pastaj do të jetë nën menaxhimin e përbashkët të Kuvendit Komunal të Podujevës dhe KIESA-s. Më tej, z. Mustafa tha se në Ligjin për investime strategjike ekziston një prioritet i disa sektorëve ekonomikë, të cilët Qeveria e Kosovës, me miratimin e Kuvendit ka menduar se janë sektorë strategjikë, që ofrojnë një potencial dhe avantazh ekonomik dhe konkurrues për Kosovën. Lidhur me mungesën e energjisë elektrike, njoftoi se marrëveshja e arritur me “Contour Global” do të sjellë një investim të ri termocentralin “Kosova e Re”, e cila do t’i plotësojë të gjitha nevojat për energji elektrike, si për ekonomitë familjare, ashtu edhe për ekonomitë prodhuese. Ai, po ashtu, njoftoi se sa i përket fuqisë punëtore, KIESA, në tetor të vitit 2017, ka bërë një anketim të 800 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë, për të identifikuar nevojat e trajnimeve. Ky anketim i është përcjellë Qeverisë, Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me qëllim që rezultatin e anketimit ta shndërrojnë në kurrikula të shkollave profesionale në Kosovë. Duke u ndërlidhur me fjalën e deputetit Ymeri, z. Mustafa tha se Qeveria e Kosovës e ka Strategjinë kombëtare të zhvillimit, nga viti 2016 deri më 2021, ku janë identifikuar edhe sektorët strategjikë, si dhe aktivitetet dhe masat strategjike që duhet të ndërmerren nga të gjitha institucionet e Kosovës. Në këtë strategji është cekur se në vitin 2018 do të bëhet një vlerësim i të arriturave dhe i rezultateve të pritura të këtyre masave dhe tani është koha që Qeveria e Kosovës të bëjë një rivlerësim të kësaj strategjie. Ka bashkërendim të KIESA-s, me institucionet tjera, por ende ka hapësirë për t’u përmirësuar. Ai tha se duhet të bëhet definimi i mandateve të agjencive të ndryshme, pasi që ka shumë agjenci dhe shpeshherë gjatë punës së tyre kanë hasur në mandate të dyfishta. Po ashtu, z. Mustafa njoftoi se përmirësimi i Kosovës në rangimin e Bankës Botërore është i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm për të tërhequr investimet, duke shtuar se Kina nuk rangohet mirë në këtë indeks, mirëpo Kina ka 1.5 miliard banorë, një fuqi të hatashme punëtore dhe blerëse. Strategjia e KIESA-së për të tërhequr investitorë të huaj që ta përdorin Kosovën si bazën e tyre të prodhimit, tha se është për shkak të kostos së ulët të prodhimit dhe pasi që MSA ofron tregti të lirë me BE-në. Studimet e fundit tregojnë se kalimi nga përpunimi në industri prodhuese dhe pastaj në ekonomi shërbyese, më nuk qëndron dhe shumë shtete kanë kaluar drejtpërdrejt në ekonomi shërbyese. Më tej, z. Mustafa tha se i vetmi sektor, në të cilin Kosova ka bilanc pozitiv tregtar, është sektori i shërbimeve, pra është i vetmi sektor ku eksportohet më shumë sesa importohet. Po ashtu, njoftoi se KIESA, së bashku me Ministrinë e Diasporës dhe me ndihmën e IOM-it dhe UNDP-së, kanë themeluar rrjetet e bizneseve të diasporës shqiptare. Qëllimi i KIESA-s, lidhur me këto rrjete është se ato të jenë të pavarura dhe nuk duhet të ketë ndërhyrje dhe kontroll nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Diaspora e Kosovës është investitori më i madh që ka Kosova dhe është e nevojshme që të jenë të organizuar në këto rrjete të biznesit. Sa i përket buxhetit, z. Mustafa njoftoi se KIESA ka buxhet prej 5 milionë eurosh, i cili nuk është i mjaftueshëm, pasi që mandati i agjencisë përfshin investimet, eksportin, turizmin, zonat ekonomike dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe janë 23 zyrtarë të punësuar. Duke e krahasuar buxhetin e KIESA-s, me agjencinë homologe në Maqedoni, tha se KIESA ka një buxhet më të vogël, fushëveprim më të gjerë dhe numër më të vogël të zyrtarëve të punësuar. Sipas tij, trendi i investimeve të huaja është lëvizës. Të hyrat mesatarisht sillen rreth 250-400 milionë euro në vit dhe lidhen me zhvillimet e fundit socio-ekonomike dhe politike që kemi në terren.

Të ndryshme

Vjosa Osmani-Sadriu, njoftoi se grupet punuese të komisionit, gjatë punës së tyre, mund të kenë mbështetjen edhe nga shoqëria civile, disa nga të cilat kanë shprehur gatishmërinë që ta mbështesin punën e grupeve punuese në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe hartimin e planit për zhvillimin e diplomacisë parlamentare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.